

VENDIM
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 25.06.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Focus Media News" sh.p.k, të ndodhur në Rruga "Ali Demi", Ish-Kombinati i Autotraktorëve, Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Focus Media News" sh.p.k, me NUIS K21909002K (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm Ortaku:

1. Shoqëria "Focus Group" sh.p.k, zotërues e 100% të aksioneve të shoqërisë, përfaqësuar nga administratori znj. Brisida Ademaj.

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakët mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Focus Media News" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Dhënien e miratimit për kalimin e fitimit të vitit 2018 dhe rezervat e akumuluar të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital.**
- 3. Të ndryshme**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar). Për sa më sipër:

ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:

- 1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar**
z. Agim Qenani lindur në Korçë, e banues në Elbasan, pajisur me Liçensë



Nr.53, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Focus Media News" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;

- 2. Të japë miratimin që fitimi i realizuar i shoqërisë për vitin 2018 në vlerën 2,885,194 (dymiljon e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) Lek si dhe rezervat e akumuluar në vlerën 106,252 (njëqind e gjashtëmijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë të kalojnë për zmadhim kapitali të shoqërisë;**
- 3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, z. Mustafa Muço, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi te autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) për efekt të regjistrimit të tij.**

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të regjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ORTAKU I VETËM

"FOCUS GROUP" SHPK

Përfaqësuar nga

Znj. BRISIDA ADEMAJ

Brisida Ademaj

